



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR SPANJËN

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti: Madrid
Popullsia: 45 milion
Sipërfaqja: 504,030 km²
Monedha: Euro
Niveli i Papunësisë: 9% (2008)

2. Viza për të vizituar Spanjën – Informacion i përgjithshëm

Të huajt që nuk janë anëtarë të BE-së kanë nevojë për vizë për të hyrë në Spanjë. Ju mund të aplikoni për vizë në ambasadën Spanjolle të vendosur (akredituar) në shtetin tuaj para se të niseni. Procedura e vizave kryhet nga Ministria e Punëve të Jashtme Spanjolle (*Ministerio de Asuntos Exteriores y de Cooperación*) nëpërmjet Ambasadave të saj jashtë shtetit:

Ambasada e Spanjës në Beograd

Prote Mateje 45,
11000 Beograd
Tel: 011/344 02 31, 344 02 32, 344 02 34
Fax: 011/344 42 03
E-mail: emb.belgrado@mae.es
E-mail i Departamentit Konsullor: emb.belgrado.vis@mae.es
Faqe interneti: <http://www.mae.es/embajadas/belgrado/se/home>
Faqe interneti e Ministrisë së Shëndetit dhe Çështjeve të Konsumatorit:
<http://www.msc.es/en/organizacion/ministerio/home.htm>

Ambasada e Spanjës në Kroaci

Tuskanac, 21 A.
10000 Zagreb.
Tel: 00 385 1 483 43 65 / 67
Fax: 484 86 08
E-mail: emb.zagreb@mae.es

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



Ambasada e Spanjës në Shqipëri

Rruga Skenderbeu, 43 Tirana
Tel: 00355 4 274 960 / 61
Fax: 00355 4 225 383
E-mail:emb.tirana@mae.es

Ambasada e Spanjës në Maqedoni

Ul, 27 Mart, n° 7, 1000 Skopje, Macedonia
Tel.: 00 389 2 3231 002 and 3220 717.
Fax: 00 389 2 3220 612

Në varësi të qëllimit për të cilin kërkohet hyrja në Spanjë, lëshohet edhe lloji i vizave të ndryshme. Aplikanti duhet të kërkojë vizën sipas nevojës pasi nuk mund të hyjë në Spanjë me vizë turistike dhe më pas të aplikojë për qëndrim të mëtejshëm me arsye të tjera, pa u kthyer më parë në vendin e origjinës dhe të marrë vizën e duhur atje. Procesi i vizave mund të zgjasë disa javë, në varësi të çdo rasti. Për të hyrë në Spanjë ka katër lloje vizash:

- Viza transiti: lejon të huajt të kalojnë nëpërmjet territorit të Spanjës brenda maksimumi 5 ditëve
- Vizë për qëndrim të përkohshëm: u lëshohet të huajve që dëshirojnë të qëndrojnë në Spanjë për jo më shumë se 3 muaj brenda një periudhe 6 mujore. Të tilla janë vizat e lëshuara për qëllimi studimi dhe vizat për qëndrimet e shumëfishta të cilat lëshohen për qëndrimet e shumëfishta deri në 90 ditë brenda një periudhe 6 mujore gjatë një viti.
- Vizë qëndrimi (që nuk është leje qëndrimi): fillimisht lëshohet për 1 vit dhe mund të rinovohet për një periudhë shtesë 2 vjeçare. Kur skadon afati, ju mund të aplikoni për vizë qëndrimi të përhershëm, e cila mund të rinovohet çdo pesë vjet. Vizat e qëndrimit merren me kushte të përcaktuara – për bashkim familjar, për të punuar në Spanjë për jo më pak se një vit dhe për azil. Kjo leje nuk u jep të drejtën për të punuar, ndaj është e nevojshme pajisja me lejen e punës.
- Vizë Nderimi për personelin diplomatik ose të ngjashëm me ta.

Për informacion të mëtejshëm shihni: <http://www.maec.es/en/Home/Paginas/HomeEn.aspx>.

Të gjitha formularët mund të merren nga faqja e internetit të Sekretarit të Shtetit të Imigracionit dhe Emigracionit në: <http://extranjeros.mtas.es/>

Shtetasit kroatë nuk kanë nevojë të aplikojnë për vizë për qëndrim të përkohshëm (C). Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë & Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë duhet të përmbushin kërkesat për vizë. Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe në Marrëveshjet e Ri-pranimin ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, shtetasit e këtyre vendeve duhet të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Holandë; megjithatë ata përfitojnë një tarifë të reduktuar vize (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas.

Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësuesi të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Shihni hollësi në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnjë dhe Hercegovinën)
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

3. Migracioni për Qëllime Punësimi

Të huajt që nuk janë nga vendet e Bashkimit Europian, por që dëshirojnë të punojnë në Spanjë duhet të pajisen më parë me lejen e punës pasi të jenë pajisur me vizë, para se të shkojnë për të punuar në Spanjë. Ata duhet të aplikojnë për vizë në Konsullatën Spanjolle në vendin e tyre.

Nëse aplikanti i huaj është në territorin Spanjoll, për lejen e punës aplikohet në Zyrën e të Huajve (*Oficinas de Extranjeros*) ose në zyrat e provincave të Ministrisë së Punës (*Delegación Provincial del Ministerio de Trabajo*),

Nëse aplikanti i huaj nuk është në Spanjë, për lejen e punës aplikohet në zyrën Konsullore në vendin e aplikantit të huaj. Zyrat Provinciale të punës (*Direcciones Provinciales de Trabajo, Seguridad Social y Asuntos Sociales*) do të vendosin nëse leja e punës do të lëshohet apo jo.

Llojet e lejeve të punës janë të ndryshme:

1) Kur një i huaj është i punësuar:

- **Lloji A** i lejes së punës: për punë stinore (sezonale) ose me kohë të kufizuar (kohëzgjatja maksimale është **9 muaj**, duke përfshirë dhe rinovimin).
- **Lloji b fillestar** i lejes së punës: për një punë në një profesion specifik, aktivitet dhe zonë gjeografike, për një periudhë maksimale **1 vjeçare**.
- **Lloji B i rinovuar** i lejes së punës: i lëshohet mbajtësve të lejes së punës të llojit b fillestar në kohën e skadimit të saj. Kjo lloj ju lejon të vazhdoni të punoni në profesione dhe aktivitete të ndryshme për një periudhë maksimale **2 vjeçare**.
- **Lloji C** i lejes së punës: i lëshohet mbajtësve të lejes së punës të llojit B të rinovuar në kohën e skadimit të saj. Kjo i jep të drejtë punëtorit të huaj të kryejë veprimtari profesionale në të gjithë territorin e Spanjës.

2) Kur një i huaj është i **vetëpunësuar**

- **Lloji d fillestar** i lejes së punës: lëshohet për të ushtruar një aktivitet të caktuar për një periudhë maksimale **1 vjeçare**. Autoritetet spanjolle mund ta kufizojnë këtë leje me një zonë gjeografike të caktuar.
- **Lloji D i rinovuar** i lejes së punës: i lëshohet mbajtësve të lejes së punës të llojit d fillestar në kohën e skadimit të saj. Kjo lloj ju lejon të ushtroni aktivitete të ndryshme profesionale për një periudhë maksimale **2 vjeçare**. Autoritetet spanjolle mund ta kufizojnë këtë leje me një zonë gjeografike të caktuar dhe/ose aktivitet të caktuar.
- **Lloji E** i lejes së punës: i lëshohet mbajtësve të lejes së punës të llojit D të rinovuar në kohën e skadimit të saj. Kjo lloj e lejon punëtorin e huaj të ushtrorë çdo aktivitet profesional në të gjithë territorin e Spanjës për një periudhë maksimale **3 vjeçare**.

3) Kur një i huaj është i **punësuar** ose i **vetëpunësuar**

- **Lloji F** i lejes së punës: lëshohet për të ushtruar aktivitet profesional në kufijtë e Spanjës, me kusht që të kthehen çdo ditë brenda kufijve të tyre, ku banojnë. Kjo leje lëshohet për një periudhë maksimale **5 vjeçare**. Pas kësaj mund të rinovohet.
- Leje pune **e Përhershme**: Kjo leje pune i lejon punëtorit të huaj të ushtrorë çdo aktivitet profesional ku ai ka kualifikimin e duhur. Mbajtësit e lejes së punës të llojit C ose E mund të marrin këtë lloj leje pune në kohën e skadimit të saj. Rinovimi i kësaj leje pune është i detyrueshëm çdo **5 vjet**.
- Leje pune **e Jashtëzakonshme**: kjo leje pune u lëshohet shtetasve të huaj nga vendet jo-anëtare të BE-së që kanë ndihmuar në rritjen ekonomike dhe kulturore Spanjolle. Kjo lloj i lejon punëtorët e huaj të ushtrorë çdo aktivitet profesional në të gjithë territorin e Spanjës ku ai/ajo ka kualifikimin e duhur. Kjo leje pune duhet rinovuar çdo **5 vjet**.

Për informacion të mëtejshëm shihni faqen e internetit të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (*Ministerio de Trabajo y Asuntos Sociales*) http://www.mtas.es/sec_emi/uk/index.htm

Të gjithë formularët mund të merren në faqen e internetit të Sekretariatit të Shtetit për Imigracionin dhe Emigracionin në: <http://extranjeros.mtas.es/>.

Faqe Interneti për të kërkuar punë:

http://www.eujobster.com/-4_Spain/.
<http://www.jobtoasterspain.com/>.
<http://spain.jobs.com/>.
<http://www.recruitspain.com/jobsearch.asp>.
<http://www.justspain.org/spain/spain-job-search.asp>.

4. Studime në Spanjë

Leje qëndrimi për Arsye Shkollimi

Statusi i qëndrimit të përkohshëm mund të përftohet për arsye shkollimi nëse periudha është më e gjatë se gjashtë muaj. Studentët që qëndrojnë më pak se gjashtë muaj nuk llogariten si imigrantë dhe studentët që qëndrojnë më gjatë se gjashtë muaj duhet të pajisen me vizë studentit dhe të regjistrohen. Sipas ligjit Spanjoll, një leje qëndrimi për arsye studimi ju jep mundësinë e bashkimit familjar. Karta e qëndrimit të studentit quhet NIE dhe për ta përfutur atë studentit duhet të aplikojë në Ministrinë e Sigurisë Publike të Spanjës (*Ministerio del Interior*) <http://www.mir.es/> kur ai/ajo sapo të ketë mbërritur në Spanjë. Ky dokument lejon studentin të jetojë në Spanjë gjatë periudhës së studimeve si dhe, lejon studentin të udhëtojë në territorin e Bashkimit Europian dhe vendeve që kanë nënshkruar marrëveshjen me Spanjën ose Bashkimin Europian për lëvizjen e lirë të njerëzve.

Nëse vendi i origjinës nuk ka një marrëveshje shëndetësore reciproke me Spanjën, atëherë studentët nuk janë të mbuluar nga Sigurimet Shoqërore Spanjolle dhe duhet të kenë sigurim privat shëndetësor në Spanjë. Studentëve të huaj nga vendet që nuk janë anëtare në BE do t'u kërkohet që të provojnë se kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike për të mbajtur veten në Spanjë. Studentët mund të lejohen të punojnë me kohë të pjesshme, por kjo konsiderohet me përjashtime, dhe ata duhet të pajisen me leje pune. Për më tepër, ata duhet t'u provojnë autoriteteve Spanjolle se aktiviteti i tyre do të jetë në përputhje me studimet e tyre dhe se të ardhurat e tyre nuk janë të nevojshme për jetesën dhe qëndrimin e tyre në Spanjë. Para se të fillojnë të punojnë, studentët duhet të pajisen me autorizim nga Zyrat për të Huajt (*Oficinas de Extranjeros*) ose zyrat Qeveritare të Punës (*Delegaciones o subdelegaciones del Gobierno, área de Trabajo y Asuntos Sociales*), dhe do t'u kërkohet të paraqesin dokumentacion si kartën e studentit dhe kontratën e punës.

Të gjithë formularët mund të merren në faqen e internetit të Sekretariatit të Shtetit për Imigracionin dhe Emigracionin në: <http://extranjeros.mtas.es/>

Lista e tetë universiteteve më të mira Spanjolle

Universidad Autónoma Madrid: <http://www.uam.es/>
Universitat de Barcelona: <http://www.ub.es/homeub/en/>.
Universidad Complutense de Madrid: <http://www.ucm.es/>
European University Barcelona: <http://www.euruni.edu/scripts/index.aspx?idz=1>.
Universitat Autònoma de Barcelona: <http://www.uab.es/>.
Universidad de Navarra: <http://www.unav.es/>.
Universitat Pompeu Fabra: <http://www.upf.edu/english/web/>.
Universitat de Valencia: <http://www.uv.es/~webuv/ingles/index.htm>.

5. Qëndrimi

Qëndrimi në Spanjë për shtetasit nga vendet jo-anëtare të BE-së është rregulluar me Ligjin për të Huajt nën përgjegjësinë e Ministrisë së Brendshme. Të huajt nga vende jo-anëtare të BE-së kanë nevojë për leje qëndrimi për të banuar në territorin e Spanjës. Për të hyrë në territorin Spanjoll do t'ju kërkohet paraqitja e pasaportës së vlefshme dhe e vizës përkatëse. Pas një periudhe **90 ditore**, nëse dëshironi të qëndroni në Spanjë, është e nevojshme të siguroni ose një shtyrje ose një leje qëndrimi.

Lejet e qëndrimit janë të **llojeve** të ndryshme:

- **Leja e qëndrimit të përkohshëm:** Ju lejon të qëndroni në Spanjë për një periudhë nga 90 ditë deri në 5 vjet, leja e qëndrimit mund të rinovohet pas kësaj periudhe të kufizuar.
- **Leja e qëndrimit të përhershëm:** Mund t'ju jepet të gjithë të huajve që kanë pasur leje qëndrimi normale për një periudhë të vazhdueshme 5 vjeçare. Kjo leje duhet të rinovohet çdo 5 vjet.
- **Leje qëndrimi për rrethana të veçanta** si p.sh për të huaj nga vende jo-anëtare të BE-së "të konsideruar për lëvizje"; të huaj nga vende jo-anëtare të BE-së të cilëve u është refuzuar aplikimi për azil dhe Ministria e Brendshme i ka autorizuar të qëndrojnë në Spanjë.
- **Leje qëndrimi për bashkim familjar:** kjo leje i jep mundësinë të huajve nga vendet jo-anëtar të BE-së me qëndrim në Spanjë, të aplikojnë për qëndrimin në Spanjë të familjes së tij më të afërt. Aplikanti duhet të ketë qëndruar brenda rregullave në Spanjë për të paktën 1 vit dhe ai/ajo duhet të ketë autorizim për një vit tjetër qëndrimi në Spanjë.

Aplikimet për lejet e qëndrimit duhet të bëhen nga vet personi pranë Zyrës për të Huajt (*Oficina de Extranjeros*) ose në Stacionin e Policisë Kombëtare, me departament për të huajt, më të afërt me qytetin ku do të jetoni. Një aplikant do të duhet të paraqesë disa dokumente në varësi të llojit të lejes së qëndrimit për të cilën ka aplikuar. **Për informacion të mëtejshëm, konsultohuni me Ambasadën e Spanjës, ose personelin e MSC.**

Rinovimet e lejeve të qëndrimit janë të mundshme, me kusht që situata ekonomike apo personale e të huajt nga vende jo-anëtare të BE-së të mos ketë ndryshuar. Kjo procedurë duhet të fillojë të paktën një muaj para se të skadojë leja e qëndrimit, përndryshe i huaji mund të gjobitet. Lejet e qëndrimit **lëshohen** nga Ministria e Spanjolle (*Ministerio del Interior*) <http://www.mir.es/>.

Ju duhet të mbani kartën e qëndrimit me vete gjithmonë pasi përbën një kartë identifikimi të detyrueshme për të huajt me qëndrim në Spanjë.

Të gjithë formularët mund të merren në faqen e internetit të Sekretariatit të Shtetit për Imigracionin dhe Emigracionin në: <http://extranjeros.mtas.es/>

6. Azilkërkues dhe Refugjatë

Në krahasim me shtetet e tjera Europiane, Spanja ka një nga ritmet më të ulëta për frymë të azilkërkuesve si dhe treguesin më të ulët të vendimeve pozitive për azilkërkuesit. E drejta për azil është manifestuar në Kushtetutën Spanjolle të vitit 1978, duke marrë në konsideratë Konventën e Gjenevës të vitit 1951 për njohjen e statusit të refugjatit. Aplikantët për azil mund të dorëzojnë aplikimet pranë Zyrës për Azil dhe Strehim në Ministrinë e Brendshme (OAR) <http://www.mir.es/>, pranë policisë kufitare ose brenda vendit. Për më tepër kërkesat e azilantëve mund të dorëzohen pranë **misioneve diplomatike dhe konsullore spanjolle në vende të tjera**. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokument të identitetit të tyre dhe deklaratë të besueshme që thekson persekutimin. Aplikimet e pranuar OAR ia kalohen Komisionit Ndër-Ministror për Azil dhe Strehim (CIAR). Komisioni përbëhet nga Ministria e Brendshme, Çështjeve Sociale dhe Punëve të Jashtme, dhe UNHCR që është në rolin e konsulentit.

Procedura e azilit në Spanjë bën dallimin mes aplikimeve për azil të dorëzuara në kufi dhe ato të dorëzuara brenda vendit. Në të dyja rastet vendimet lëshohen nga CIAR brenda 6 muajve nga koha e aplikimit, duke marrë në konsideratë dosjen informative të OAR dhe rekomandimet e bëra nga UNHCR dhe OJF. Gjatë kohës së pritjes së përgjigjes të aplikimit, mund të jepen disa të drejta si ajo leje pune dhe leje qëndrimi, ndonëse kjo bëhet në raste të veçanta. Grupet e pambrojtura ndihmohen nga *Instituto de Mayores y Servicios Sociales* (IMSERSO). Në rastin e aplikimit në kufi, parashikohen procedurat e përsheptuara të pranimit për tre ditë për vendimin fillestar. Në rastet e pranimit pozitiv, vendimi mund të jepet për mbrojtje si refugjat, ose me statusin humanitar ose të të zhvendosurit dhe do të lëshohet leja e qëndrimit. Nëse kërkesa për azil refuzohet, personi ka të drejtë të kërkojë ri-shqyrtimin e aplikimit për azil brenda një dite (24 orëve), që duhet të vendoset nga Zyra për Azil brenda 48 orëve. Në rastet kur aplikimi është refuzuar, pranimi në këtë territor mund të lejohet nëse UNHCR mbështet aplikimin për azil. Gjithashtu është e mundur të apelohe brenda një periudhe dy mujore para Gjykatës së Lartë Kombëtare. Me marrjen e një vendimi negativ, autoritetet Spanjolle mund të refuzojnë dhe largojnë aplikantin për azil, duke marrë parasysh Konventën e Gjenevës. Aplikimet për azil të dorëzuara brenda vendit duhet të finalizohen me vendim brenda 60 ditëve. Pas dorëzimit të aplikimit për azil, azilkërkuesit kanë të drejtën të përdorin përkthyes, këshilltarë ligjorë dhe asistencë mjekësore, ashtu si dhe në rastet e aplikimit në pikat kufitare. Aplikantët mund të qëndrojnë në Spanjë për jo më shumë se 60 ditë ndërsa presin

vendimin për aplikimin e tyre. Mos pranimit duhet t'u njoftohet aplikantëve brenda katër ditëve nga data e marrjes së vendimit. Në rast të një vendimi negativ duke përfshirë edhe një apel të mundshëm, personi është i detyruar të largohet nga vendi brenda 15 ditëve, por rezervon të drejtën të aplikojë për mbrojtje humanitare.

Të gjithë formularët mund të gjenden në faqen e internetit të Sekretariatit të Shtetit për Imigracionin dhe Emigracionin në: <http://extranjeros.mtas.es/>

7. Bashkimi Familjar

Procedura për bashkim familjar është shtrënguar në Spanjë. Një aplikant duhet të jetojë në Spanjë për të paktën një vit dhe të ketë lejen e qëndrimit, të dhënë në Spanjë ose në një nga shtetet e BE-së, për një periudhë dy- vjeçare, në mënyrë që të aplikojë për bashkim familjar. Aplikanti (që nuk është shtetas) që ka marrë lejen e qëndrimit nëpërmjet bashkimit familjar ka të drejtën e bashkimit familjar pasi të ketë marrë një leje qëndrimi personale (të pavarur) dhe lejen e punës (pas pesë vjet qëndrimi) dhe mund të tregojë të ardhura të mjaftueshme për mbështetje. Lejet e qëndrimit të bazuara në bashkim familjar **lëshohen** nga Ministria e Brendshme Spanjolle (*Ministerio del Interior*): <http://www.mir.es/>.

Të gjithë formularët mund të gjenden në faqen e internetit të Sekretariatit të Shtetit për Imigracionin dhe Emigracionin në: <http://extranjeros.mtas.es/>

8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor

Të drejtat për mbrojtjen e shëndetit i kanë të gjithë shtetasit Spanjollë dhe të huaj brenda territorit kombëtar Spanjoll, si dhe shtetasit e shteteve jo-anëtare të Bashkimit Europian të drejtat e të cilëve njihen nga çdo ligj i zbatueshëm, marrëveshje dhe konventa. E drejta për shërbimet sigurohet pasi të keni paraqitur Kartën Personale Shëndetësore të lëshuar nga Departamenti i Shëndetësisë përkatës. Ky dokument identifikon çdo shtetas si përdorues të të gjithë Sistemit Kombëtar. Kujdesi shëndetësor në Spanjë është **një përfitim pa kontribut**. Ai paguhet nëpërmjet taksave dhe përfshihet në buxhetin e përgjithshëm për çdo Komunitet Autonom. Dy fondet shtesë janë Fondi i Kohezionit i menaxhuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve të Konsumatorit dhe Programi i Kursimeve për Paaftësi të Përkohshme. Për informacion të mëtejshëm shihni faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve të Konsumatorit në: <http://www.msc.es/en/organizacion/ministerio/home.htm>. Vini re se pjesa më e madhe e informacionit në këtë faqe është në gjuhën Spanjolle.

9. Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Kushtetuta Spanjolle parashikon se autoritetet publike mbajnë një sistem publik të sigurimeve shoqërore për të gjithë qytetarët që do të **garantojë asistencë dhe shërbime sociale** të cilat janë të mjaftueshme për rastet e nevojshme. Asistenca dhe shërbimet shtesë janë falas. Sistemi Spanjoll i Sigurimeve Shoqërore **mbulon** të huajt me leje qëndrimi në Spanjë. Mbrojtja gjithashtu i ofrohet edhe familjes së personit të siguruar. Kontributet e Sigurimeve Shoqërore Spanjolle fillojnë ndërkohë që filloni të punoni në Spanjë, jo kur merrni [kartën e qëndrimit](#). Sistemi i Sigurimeve Shoqërore Spanjolle përfshin **përfitime për kujdes shëndetësor** (sëmundje dhe shtatzëni), **dëmtime në punë, papunësi, pensione, paaftësi dhe vdekje**. Aplikimet për Numrin e Sigurimeve Shoqërore merren pranë Thesarit Qendror për Sigurimet Shoqërore.

Informacion i mëtejshëm mund të gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (*Ministerio de Trabajo y Asuntos Sociales*): http://www.seg-social.es/Internet_6/index.htm. Shënim: pjesa më e madhe e informacionit gjendet në Anglisht; sidoqoftë, disa seksione janë vetëm në gjuhën Spanjolle.

10. Strehimi

http://www.sublet.com/State_Rentals/Spain_Rentals.asp
<http://www.apartments-spain.com/>.
<http://www.gomadrid.com/apartments/>.
<http://www.rentalspain.com/>.

11. Njohja e Diplomave dhe Gradave të Huaja

Studentët që kanë përfunduar studimet e tyre në një universitet ose qendër të arsimit të lartë jashtë shtetit dhe që kanë dëshirë të vazhdojnë studimet e tyre në një Universitet Spanjoll mund (i) ose të aplikojnë për të njehsuar diplomën e tyre si një kualifikim zyrtar në universitet spanjoll ose (ii) të aplikojnë që të njihen studimet e tyre si të ekuivalente me studimet Spanjolle përkatëse.

Studentët duhet të kenë parasysh se këto dy procedura nuk mund të ndërmerren njëkohësisht. Aplikimet për njehsimin e diplomës së dhënë jashtë shtetit duhet të dërgohen pranë Departamentit të Kualifikimeve Akademike, Njohjes dhe Njehsimit (Paseo del Prado, 28 - 28014 Madrid; Tel. (34) 917 018 500)

12. Shërbime Mbështetëse për Migrantët

Sekretariati i Shtetit për Imigracionin dhe Emigracionin (Secretaria de Estado de Inmigración y Emigración): <http://extranjeros.mtas.es/>.

Komisioni Spanjoll për Refugjatët OJQ (Comisión Española de Ayuda al Refugiado (CEAR) <http://www.cear.es/home.php>.

Qendra Kërkimore për Paqen OJQ (Centro de Investigación para la Paz (CIP)) <http://www.fuhem.es/cip-ecosocial/>.

Organizata për luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë, ndihmë ligjore për imigrantët (Sosrasizmo): www.sosracismo.org

Tel: +34 944790310

Bota e Katërt – integrimi i imigrantëve, edukimi dhe të drejtat e njeriut: www.cuartomundo.es

Tel: +34 914481445

Asociación Amanecer, R&A de ayuda al inmigrante

Almería: c/Granada, 190 en: Almería 04008 (Almería) (España)

Tel.: 950254453 E-Mail: amaneceralmيريا@yahoo.es

13. Shtetësia

Ata që nuk janë shtetas spanjollë mund të përftojnë shtetësinë Spanjolle sipas Ligjit Civil, të ndryshuar me Ligjin 36/20028 më 8 Tetor 2002. Shtetësia spanjolle mund të kërkohet nga të huajt në mënyra të ndryshme.

- Njëpërmjet lindjes: çdo fëmijë i lindur në Spanjë, prindërit e të cilit janë të huaj dhe nëna ose babai janë të lindur në Spanjë, çdo fëmijë i lindur në Spanjë prindërit e të cilit janë persona pa shtetësi
- Njëpërmjet qëndrimit: kërkesa bazë për të aplikuar për shtetësinë Spanjolle është qëndrimi i vazhdueshëm në Spanjë për një periudhë **10 vjeçare**. Kjo varion për ata persona të cilëve u është dhënë **azil**, e në këtë rast kërkohet qëndrimi 5 vjeçar. Qëndrimi **2 vjeçar** kërkohet për personat me origjinë Hebre Sefardik. **Periudha e qëndrimit është reduktuar në 1 vit për ata persona që kanë lindur në Spanjë**, prindërit e të cilëve janë të huaj me qëndrim të ligjshëm në Spanjë;
- Për **bashkëshortin/en e një shtetasi/e** Spanjoll/e;
- Për ata persona që **nuk kanë aplikuar** për shtetësi Spanjolle brenda **periudhës ligjore** të vendosur për të kërkuar shtetësinë Spanjolle sipas zgjedhjes;
- Për **të ve/në e një shtetasi/e Spanjoll**, në rast se bashkëshortët nuk janë ndarë në kohën e vdekjes së bashkëshortit/es;
- Për të huajin, babai, nëna, gjyshi apo gjyshja i të cilit/ës ka qenë **shtetas spanjoll nga lindja apo qëndrimi. Shtetësia e dyfishtë** nuk u njihet migrantëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor. **Formulari**

i aplikimit zyrtar për të aplikuar për shtetësinë Spanjolle duhet të dokumentohet pranë Regjistrit Civil dhe të korrespondojë me qytetin ku jeton aplikanti.

14. Institucione Qeveritare përgjegjëse për imigracionin

Ministria e Punëve të Jashtme të Spanjës (*Ministerio de Asuntos Exteriores y de Cooperación*)
<http://www.maec.es/en/Home/Paginas/HomeEn.aspx>.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (*Ministerio de Trabajo y Asuntos Sociales*): http://www.seg-social.es/Internet_6/index.htm

Ministria e Brendshme Spanjës (*Ministerio del Interior*): <http://www.mir.es/>.

Ministria e Shëndetit dhe Çështjeve të Konsumatorit (*Ministerio de Sanidad y Consumo*):
<http://www.msc.es/en/organizacion/ministerio/home.htm>